



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-38141/21
Kaçanik, 29.12.2021

Në bazë të nenit 12.2(d) lidhur me nenin 40.2 (c) dhe (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës 01Nr. 6/01-12895/20 të datës 30.06.2020, të nenit 15.1(c) lidhur me nenin 55 të Rregullores 01Nr. 7864/08 për Punë të Kuvendit të Komunës të datës 13.11.2008, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 dhjetor 2021, mori këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË
KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2022

1. Me këtë Vendim, formohet Komisioni për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, në përbërje prej 5 anëtarëve, 4 anëtarë do të jenë nga Kuvendi i Komunës dhe 1 anëtar nga Zyra e Kryetarit të Komunës, si vijon:

1.1.	Kemal Murseli,	kryesues	nga KK
1.2.	Adnan Reka	anëtar	nga KK,
1.3.	Arlinda Rakoci-Raka	anëtar	nga KK
1.4.	Agim Çaka	anëtar	nga KK
1.5.	Makfire Malsiu	anëtar	nga Zyra e Kryetarit

2. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi do të hartoj Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022 dhe për të njëjtin do t'i zhvilloj procedurat e nevojshme sipas rregullave ligjore në fuqi deri me miratimin e planit nga Kuvendi i Komunës.

3. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 –Për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e komisionit, Kryetari i Komunës dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Makfire Malsiu

From: Vjosa Ahmetaj
Sent: Thursday, January 20, 2022 9:10 AM
To: Kemajl Murseli
Cc: Besim Murtezani; Gëzim Sahiti; Makfire Malsiu
Subject: Njoftim....

I nderuar,

Bazuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, (shtojca II - Aktet e organeve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të Komunës së Kaçanikut, si në vijim:

- Vendimi 01 Nr. 60/01-381414/21 për formimin e komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, vendim i datës 29.12.2021, vlerëson se akti i komunës nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj
Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave
Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave – MAPL
Tel: +381 (0) 200 35 662
E-mail: vjosa.ahmetaj@rks-gov.net
Adresa: Pallati i Shtypit Ish-Rilindja